

JORGJI GJINARI

## VËZHGIME MBI TË FOLME TË KRUIJËS DHE TË MALËSISË SË KRUIJËS

Një studim mbi gjuhën e të gjithë rrethit të Kruijës: të qytetit, të Malësisë, të Fushës dhe të Rancisë, do të jepte një pamje të plotë mbi të folmet e këtij rrethi, por ne, meqenëse gjer tashti kemi bërë kërkime vetëm në tri <sup>1)</sup> pika të banuara, po kufizohemi hëpërhë me të folmen e Kruijës (qytet), Cudhinit dhe Mafsheqit.

Për hartimin e këtij punimi jemi mbështetur në materialin gjuhësor të mbledhur prej nesh në Kruijë në prill të vitit 1960 dhe në Mafsheq e Cudhin në shtator të vitit 1961. Kur kaluam nga Cudhina në Mafsheq, u ndalëm edhe një ditë në katundin Noe; aty bëmë një vrojtim të shpejtë dhe mbledhëm pak material sa për t'u njohur me të folmen e këtij katundi. Të dhënat e mbledhura në Noe i kemi përdorur në këtë punim si material plotësues dhe krahasues.

Qëllimi ynë kryesor ka qenë njohja me gjuhën e brezit të vjetër<sup>2)</sup>, prandaj edhe këtu ne do të japim të folmen e kësaj zone në gjendjen e saj të ruajtur.

Zona e përshkruajmë së bashku në punimin tonë si gjuhën e qytetit të Kruijës edhe atë të katundeve Cudhin e Mafsheq, sepse, po të lëmë mënjanë disa ndryshime të pakta, ato janë shumë të afërta midis tyre. Edhe nga pikëpamja gjeografike Cudhina e Mafsheqi janë afër me Kruijën, mesatarisht që të dy janë 7-8 km. larg prej këtij qyteti.

Gjer tani nuk ka pasur ndonjë studim gjuhësor mbi të folmen e Kruijës. Një njoftim mbi disa veçori të sajat gjejmë tek një relacion i M. Lambert-zit<sup>3)</sup> ku ndër të tjera thuhet: "Dialekti i Kruijës nuk është krejt identik me dialektin e Durrësit dhe të Elbasanit, që ka përshkruar Weigandi, por duhet studuar edhe shënuar veçanërisht . . ." Tashti vonë janë botuar të dhëna e studime dialektologjike mbi të folmen e Matit<sup>4)</sup> që lidhet me këtë të Kruijës gjeografikisht dhe gjuhësisht.

Zona, gjuhën e së cilës kemi marrë këtu për objekt studimi, është një vend malor në Shqipëri të Mesme. Qyteti i Kruijës shtrihet në shpatin jugperëndimor të malit të Skënderbeut, ndërsa katundet Cudhin e Mafsheq, që bëjnë pjesë në Malësi të Kruijës, gjenden prapa këtij mali. Kruija dhe Malësia nga V. e L. kanë Matin, nga J.L. Malësinë e Tiranës dhe nga P. Fushën e Kruijës.

1) Kemi bërë edhe një ekspeditë informative në katundin Luz të Fushës së Kruijës në nëndor të vitit 1955. Materialin e këtij katundi e kemi përdorur këtu vetëm sa për të bërë ndonjë krahasim dhe për të dhënë shtrirjen e ndonjë fenomeni gjuhësor.

2) Në Kruijë kam punuar me nëntë burra të moshës 50-75 vjeç dhe me tri gra të moshës 45-55 vjeç. Në Malësi kam punuar me njëmbëdhjetë subjekte (të gjithë burra), shumica e të cilëve ishin të moshës 62-80 vjeç, vetëm një ishte 33 vjeç. Përveç leksikut, pjesa më e madhe e materialit tjetër gjuhësor është mbledhur me metodën e bisedës së lirë.

3) "Bericht über meine linguistischen studien in Albanien von Mitte Mai bis Ende August 1916" në Anzeiger der K. Akad. d. Wis. in Wien Ph. h. kl. 1916

4) Shih: K. Ylqini - "Disa vëzhgime mbi të folmen e Matit", në Bulet. Un. Shtet. Seria Shk. Shoq. 3, 1961 dhe B. Beci - "Hulumtime gjuhësore në Mat" (Fonetika), në Bul. Un. Shtet. Seria Shk. Shoq. 2, 1962.

Malësia e Krujës lidhet me Matin nëpërmjet Qafës së Shtamës dhe me Krujën nëpërmjet Qafës së Vajës. Nëpër Krujë dhe përmes Malësisë kalon një rrugë automobilistike që shkon deri në Burrel.

Malësi Kruje quhet vendi që shtrihet prej zallit të Mnerit deri në Breg të Matit. Katundet e saj përfshihen në dy krahina: në Kurbi dhe në Benë.

Pjesën më të madhe të Benës e përbëjnë fshatrat e Tiranës. Në këtë rreth etnografik hyjnë dy fshatra të Krujës: Cudhini dhe Bruzi. Pjesa tjetër, shumica e fshatrave të M. Krujës, bëjnë pjesë në Kurbi, i cili fillon nga Qafa e Cudhinit dhe mbaron në lum të Skurrajt. Në Kurbi hyjnë: Noe, Mafsheq, Shkretë, Malbardh, Selita e Keqe, Vinjall, Gallatë, Daul-lukapiç-Skurraj, Dylbnesht, Milot, Sullaz, Gjonëm, Zhej, Shumri, Berret, Laç,

Thamë se Cudhini bën pjesë në krahinën e Benës dhe dallohet për nga zakonet me fshatrat e Kurbinut, por, megjithatë, ai ka qenë i afuar e i lidhur me Kurbinin<sup>1)</sup>.

Kruja me rrethin e saj ka qenë lidhur administrativisht herë me Durrësin dhe herë me Tiranën, ndërsa sot është rreth më vehte. Lidhjet ekonomike i kanë pasur më shumë me Tiranën. Banorët e qytetit të Krujës shkonin në pazaret e Tiranës jo vetëm për të blerë mallrat që u nevojiteshin, por dhe për të shitur prodhimet e tyre të zejtarive që ushtronin<sup>2)</sup>. Malësia më shpesh zbriste në pazarin e Krujës dhe më pak në atë të Tiranës, kurse në Burrel shkonte shumë rrallë. Rrugët që lidhin sot Krujën me Tiranën e Durrësin janë pothuaj të barabarta — rreth 50 km. të gjata.

Më parë rrugët që lidhin Krujën me këta dy qytete mund të përshkoheshin me këmbë ose me kafshë për 6-7 orë.

Më 1961 qyteti i Krujës kishte 6330 banorë<sup>3)</sup>. Nga statistika<sup>4)</sup> e vitit 1923 del se ky qytet ka pasur 3583 banorë, pra popullsia ka ardhur duke u shtuar, megjithëse prej Kruje edhe janë shpërngulur familje që kanë zënë vend sidomos në Tiranë e Durrës. Nga një relacion<sup>5)</sup> i Nikollë Mekajshit, viti, 1603, marrim vesh se në kalanë e qytetit kishte pak banorë, por jashtë mureve të saj kishte mbi 700 shtëpi.

Banorët e qytetit janë marrë me zejтари e tregëti, por njëkohësisht dhe me bujqësi, sepse ekonomia e Krujës ka edhe karakter bujqësor: gati të gjitha familjet kanë bahçe me ullinj e kopshte, disa kanë edhe vreshtë e toka buke. Malësia merret më shumë me bujqësi, blegtoria është më pak e zhvilluar.

Në Krujë krushqitë bëhen zakonisht brënda qytetit, por marrin gra edhe nga fshatrat e afërt. Malësia merr vajza edhe në Mat, shkojnë gjer në Macukull, por nuk jep andej, merr e jep me Malësinë e Tiranës, shkojnë deri në Bushnes; gjithashtu edhe fshatrat e Malësisë japin e marrin me njeri tjetrin, kurse në fushë vetëm japin vajza, nuk marrin, sepse fusharakët nuk i ngjisin bijat e tyre në Malësi.

Kësulata në Malësi i mbajnë të rrafshata, si matjanët, kurse në Krujë i kanë sferike, si malësorët e zonave të Shqipërisë Veriore.

Për shkak të marrëdhënieve të ndryshme dhe të vazhdueshme që kanë pasur Kruja me Malësinë, janë formuar tek ato tipare kryesore të përbashkëta etnografike dhe për pasojë edhe gjuhësore, të cilat do të vihen në dukje në punimin që pason.

1) Cudhini ka pasur e ka marrëdhënie farefisnore me fshatrat e Kurbinut dhe, shpesh herë, më parë, për zgjidhjen e konflikteve thërriste pleq nga ato anë.

2) Në Krujë ka pasur sidomos shumë këpuçarë, kurse gratë merreshin e merren akoma edhe sot me endjen e pëlurave.

3) *Anuar statistikor i R. P. Shqipërisë*, viti 1961.

4) *Po aty*.

5) Informata mbi relacionin na është dhënë prej shokut I. Zamputi.

## F O N E T I K A

Në të folmen e trekëndëshit<sup>1)</sup> gjuhësor Krujë-Cudhin-Mafsheq interes të veçantë paraqet fonetika, sidomos sistemi i zanoreve. Në këtë drejtim kjo e folme ndryshon mjaft prej të folmeve të Tiranës e Durrësit, sepse disa zanore të theksuara janë diftonguar ose janë zhvilluar duke kaluar në më të hapta ose më të mbyllta.

*Vendi i theksit në fjalë.* — Fjalët oksitone me origjinë turke edhe këtu janë kthyer në fjalë paroksite. Si në të folmet e tjera geqe edhe këtu ndërrimi i vendit të theksit ka sjellë në këto fjalë ndryshime fonetike e morfologjike: *hájrr* (hair), *dájrr* (daire), *dáj* (dai), *valláj* (vallai), *báb-bába* (baba-babai), *ág-ága* (aga-agai), *dáj-dája* (dai-daiu), *shamát-shamáta* (shamatá-shamataja), *káve-kávja* (kafé-kafeja), *qóshe-q shja* (qoshé-qoshéja), *séne-sénja* (sené-seneja), *Tíme-Tímja* (Fatimé-l'atimeja), *havále-haválja* (havalé-havaléja), *nisésh-te-nisésh-tja* (niseshtë-niseshtëja).

Nga fjalët autoktone të shqipës, që në të folmet geqe më veriore janë paroksite, këtu vetëm përmiri ai del herëherë paroksiton, edhe ky më tepër në Malësi të Krujës.

Në tri fjalë të shqipës, të formuara me anë prapashtesash ose me anë të përngjitjes, theksi ka mbetur në fjalën rrënjë: *újs* (=újis), *újsim* (=ujisim); *tutjé* ose *tulé* (=tutje); *kaqá* (=kaqë).

*Zanore të gjata.* — Si në mbarë gegërishten edhe këtu ka zanore të gjata në pozita fonetike të caktuara. Më tepër zanoret e gjata vërehen në rrokje të hapura fundore: *im vllá*, *ká* (ka-u), *merá*, *ná*, *trá*, *bé*, *qé*, *drú*, *njerí*, *t zí*, *e mí*, *bí*; *me pá*, *u pat vrá*, *ka lé*, *vra e ká*, *ká vú*, *máirse t pru zoti!*, *mé ké çú*; *flú*, *tu m besú s je*, *á° zblú*.

Zanorja e theksuar shqiptohet e gjatë në ato raste që fjala ka mbaruar me *ë* të patheksuar, e cila sot nuk ndihet: *sháll*, *Sál* (Sala=Sali), *váth*, *djáth*, *níal*, *búk*, *fúsh*, *kúrr*, *dór*, *vón*, *plagés*, *koktrásh*, *gjúm*, *vét*, *krú p*, *shók* (shokë), *grát*, *t lígta*, *t lídh*, *gréjm* (ngrejme) etj.

Zakonisht është e gjatë zanorja e theksuar edhe kur ndodhet në një rrokje fundore të mbyllur nga bashkëtingëlloret *r*, *ll* (zakonisht kur *r* është tingull i prapashtesës *ar*): *mentár*, *rrogjár*, *kufijár*, *venár*, *druár* (druvar), *mullár*, *zár* (=zagar), *ç ll*, *p ç ll* etj.

Veç rasteve *flú*, *tu m besú* e tjera që pamë më sipër, ka edhe shumë të tjera që tregojnë se diftongjet, duke u monoftonguar, edhe kur kanë qenë në rrokje të mbyllura, kanë dhënë zanore të gjata: *kali jú*, *sa t dúsh*, *múr*, *qershúr*, *kallnúr*, *t lún*, *dýr*, *díll* etj.

Në të gjitha këto raste që përmendëm zanorja e gjatë kthehet e bëhet e mesme sa herë që ndryshohet pozita e saj fonetike kur fjala merr forma të ndryshme gjatë fleksionit: *ká*—*kau*, *pat vrá* — *vrava*, *búk*-*buka* — *bukën*, *kallnúr*-*kallnuri*, *druár*-*druari* etj. Në disa fjalë të tjera të kufizuara në numur, ku zanorja e gjatë gjendet në një rrokje të brendëshme të fjalës dhe ku nuk është pozicionale as e ardhur nga zhvillimi fonetik i fjalës, mbetet gjithmonë e gjatë: *mórtja*, *skúraj*, *káve*, *détin*, *me shpírri*, *déhen*, *xhámí*, *i paditshëm*.

*Zanore hundore.*—Janë hundore të gjitha zanoret e theksuara që ndiqen ose që kanë qenë ndjekur dikur prej bashkëtingëlloresh hundore të rrënjës ose të temës së fjalës. Në të dyja kategoritë, si në ato që pasohen sot nga

1) Këtë tutjepër të folmen e trekëndëshit tonë gjuhësor do të të hem e *folnja e Krujës*<sup>s</sup> Kur do të kemi të bëjmë me ndryshime midis Krujës (qytet) dhe Cudhinë e Mafsheqit, këta të fundit dhe (i përmbledhim në emrin *Malësia e Krujës*, ndërsa për Krujën do të themi: *qyteti*

bashkëtingëlloret hundore, edhe në ato që janë pasuar dikur prej këtyre bashkëtingëlloreve, shkalla e nazalitetit është e njëjtë dhe e madhe:

a) *llá°ŋa, ká°mat, lá°ŋza, me há°ŋër, Buze Cã°ŋut, vrã°nët, z°ŋ, kllo°ŋsa* (hullonjësja), *ka qën, rrush vëns, pëni, trãngt, tũnsine hĩni, mshĩni, gjĩnat;*

b) *bã°het, ta zã°jsh, há°, vã°th, atã° (atë), mã°zi, ustë°ja (osteni), pulastrë, hi, shihet, mtãĩ (mti-ni), fr°ŋ (fryn), drũ, krũ, hũj, frũt, zũ, prũ, ũ (=unë).*

Hundore janë zanoret, sidomos *a* dhe *i*, edhe kur gjenden pas bashkëtingëlloreve hundore, porse në këto kushte shkalla e nazalitetit është më e vogël se tek zanoret hundore të mirëfillta: *mĩfim, i her* (nji herë), *tramã°*, *kumã°she, gamã°r, Mã°l* (Ismail), *mã°stre*.

Në analogji me rastet e mirëfillta këtu janë bërë hundore edhe zanoret fundore *i* e *u* (<ue) të temave në formën foljore të pjesores që ka pasur dikur bashkëtingëlloren *m* në prapashtesë: *me zĩ, e përzĩme, me grĩ, tu kĩ ullzĩt, me provũ, paske bishtũ, tue trenũ, tu vathũ, u ka zmadhũ*.

Zanoret *i* dhe *u* janë hundore edhe në një numër rastesh të tjera, në të cilat s'ka asnjë kusht për nazalizim. Në këto raste këto zanoret ose janë në fund të fjalës në rrokje të hapura pse përpara bashkëtingëllores *z*: *shumrĩ, gjershĩ* (qershi), *kuszĩ* (kusi), *flija, urĩth* (uri-th), *gërfũ, ktũ, qetũ, qitũ, kshtũ, gjũtha* (gjũ-tha); *gjĩz, kĩz, shpũz, bũz*.

#### Zanoret në rrokje të theksuara

a. — Në të folmen e Krujës *ã* është më e prapme dhe më e mbyllët se *a*-ja e mbarë shqipes, për nga shqiptimi i afrohet kështu një *o*-je të hapët të cilën po e shënojmë me [*ã°*]:

a) *kã°mat, mrã°ma, kallã°ma, tã°mël, dhã°nri, lã°ŋza;*

b) *gjã°, s'ka për tu bã°, mã°, shullã°, ã°sht, vã°th*.

Edhe në fjalë me origjinë turke apo të gjuhëve të tjera, të hyra vonë në shqipe, *a*-ja që ndodhet përpara bashkëtingëlloreve hundore ka kaluar në *ã°*, ka pra po atë ngjyrim dhe po atë timbër që ka kjo zanore dhe në rastet e përmendura më sipër: *ũsã°n, çopã°n, shejtã°n, nishã°nash takã°min, plã°nin* etj.

Këtu *a* ka kaluar në *ã°* edhe në fjalët ku ajo ndodhet pas bashkëtingëlloreve hundore (për shkallën e nazalitetit të *ã°*-së në këto raste shih paragrafin e zanoreve hundore f. 6); *hamã°r, damã°te* (domate), *mã°gje, mã°j, kumã°she, qimã°sre, mã°c, mã°rrin, knã°qte, spinã°q, nã°p, Viŋã°ll, niã°llet, dŋã°ja* (dynjaja).

Tek foljet *përzã°n, zã°j, gjã°jm* (këto dy të fundit më rrallë dhe vetëm në Malësi) është ruajtur zanorja *ã°* e temës dhe nuk ka evoluar në *ẽ* si në mjaft të folme gege. Zanorja *ã°* ndihet sot edhe tek trajtat e këtyre përmrave: *atã°* (krh.: *ate-atë*), *për tã°* (të) *me gatã°, kã°* (kë), *niã°ni* (njeni), tek numërori *niã°* (vetëm kur është fjala me theks) dhe tek ndajfolja *kaqã°* (krahas kësaj ndeshet edhe varianti *kaqi*).

*a*-ja gojore është si në shumë të folme të tjera e ngritjes së ulët, e radhës së mezit e palabializuar.

e. — Sot në të folmen e Krujës, veç *e*-së së zakonëshme të ngritjes së mesme, dallohen edhe dy variante të tjera: një *e* e hapët [e] dhe një *e* e mbyllët [e̞] e cila të shumtën e herës zbërthehet dhe jep një diftongoid *ie*.

1. — Zanorja *e* është e hapët [e] rregullisht në ato fjalë ku është hundore: *mrë°n, klysh që°ni, ka që°n, u trë°mshim, më°njen, shë°mra, rrush vë°ns, për ç°mnit, apë°nga, plë°hën, rrë°j, e zë°jshim, po t lë° ta gjë°j, zë° ustë°, strë°*.

Këtu *e*-ja shqiptohet e hapët edhe në një numur të madh fjalësh ku ajo është zanore gojore: *m deĳ, deĳi, xhëp, tëfi, tuté, mshtët, pëtkat, këç, këpat, gëç, thëç, tu çël, thë-u, pllë, vëtell, vëshat, vët, zdërveç, zëkthi, hëkrat, tu hëç, shkërësa, Shkërëta, ərđha, shërçp, epte, nëpshin, galaçep*. Megjithëse duket sikur në këto raste timbri i kësaj zanoreje lidhet me bashkëtingëlloren që ka pranë, sidomos me atë që e paraprin, prapsepapë një rregullsi e plotë nuk del, sepse e kundërshtojnë rastet e tjera ku në po ato pozita ka *e*. Më tepër ka të ngjarë që të jetë e kushtëzuar nga gjatësia, kështu në më shumë raste ajo është e shkurtër dhe në disa e mesme e pasuar nga dy bashkëtingëllore.

2. — Në Malësi, ndryshe nga Kruja, një *e* gojore e gjatë dhe e mesme nën ndikimin e bashkëtingëlloreve paraprijëse *q, l*, në disa raste edhe të *h*-së, është zbrërthyer në mjaft fjalë dhe ka dhënë një diftongoid *ʎ*: *q'ief, me gā q'iet, trëin q'ësh, bereq'ëin, q'ësim, l'e (len), i l'et, me bl'e, bl'eva, pl'eshia, l'etrën, prij l'eshit, l'ek, xhel'ek, Ma'li L'eçes, h'edhim, h'ek*.

i. — E folmja e Krujës hyn në atë grup të folmsh të shqipes ku diftongohet zanorja *i* e theksuar. Fenomeni ka vepruar aty po në atë masë, sikurse edhe në krahina të tjera<sup>1)</sup> që shquhen nga kjo anë, si Mati, Dibra, Lura, Luma, Kosova Jugore. Ky fenomen kap edhe Fushën e Krujës e shkon gjer në Ishëm.

Variantet e diftongjeve që kanë dalë nga zbrërthimi i kësaj zanoreje janë të ndryshme nëpër të folme të ndryshme.

Në zonën e kësaj së folmeje mbizotëron varianti *ʒi*, ku elementi kryesor *ʒ* i këtij diftongu është një *e* e hapët dhe disi e prapme, pra që i afrohet *ë*-së: *mʒir, mʒ ik, mʒ isrit, a nʒiveʒ i rrʒitshëm, a gdhʒine mʒir, shʒifte, për kapʒistre, shʒiu, t lëi.ʒtme, e ɾʒshëm, karthʒie, kaptʒina, shpʒin, tʒi, ardʒhi, kushrʒi, i ka shit dhʒit veresʒi, tapsʒi* (tepsi).

Aty këtu, sidomos në Malësi, hasen edhe raste ku komponenti i parë dhe kryesor i diftongut është *e* disi e hapët [e] fazë kjo që kronologjikisht duhet të ketë ardhur përpara *ʒi*. Rastet, siç thamë, janë shumë sporadike dhe, përveç kësaj, ndër ta nuk shohim dot sot ndonjë rregullsi, sepse jo vetëm që e gjejmë po në ato kushte fonetike ku gjejmë *ʒi*, por edhe në të njëjtat fjalë: *mtëʎ, rrëʎtet, shpëʎa, hëʎku, t vërçite, dheʎt, tre'n, nëʎshëm*.

Në një numur të vogël fjalësh, më tepër në qytet se sa në Malësi, në vend të *i*-së së theksuar gjejmë edhe një zanore të vetme, një *e* të hapët [e], e gjejmë sidomos në ato pozita ku *i*-ja është e shkurtër ose e mesme: *sët* (sit), *prën*, *mërdhëç*, *mos prëtni! vrëtni! demëroçhak, përçete, gdhënte, tu trënu, e mrëni, tu dhënte*.

Një variant tjetër është diftongu *ai*. Ky haset vetëm në Malësi (më tepër në Cudhin) dhe në një numur të kufizuar rastesh.

Zhvillimi *i > a<sup>i</sup>* (*a<sup>i</sup>* duhet të ketë ardhur nga *ʒi*) duket se nuk është i kondicionuar fonetikisht, *a<sup>i</sup>* gjendet në shembuj po të atillë dhe në pozita po të atilla ku gjenden edhe variantet e tjerë të ardhur nga zhvillimi i *i*-së: *dha<sup>i</sup>, me pa<sup>i</sup>, kam pas na<sup>i</sup> m at koh, shpa<sup>i</sup>, vakia<sup>i</sup>, ardhia<sup>i</sup>, kaca<sup>i</sup>, ma. ɾ, ma<sup>i</sup>k, ha<sup>i</sup>ç, ha<sup>i</sup>sku, fa<sup>i</sup>k, mta<sup>i</sup>ni, va<sup>i</sup>shite, masha<sup>i</sup>m*.

Diftongimi *i > a<sup>i</sup>* konstatohet edhe në krahinën e Matit<sup>2)</sup>. që është

1) Shih N. Jokl: *Vorläufiger Bericht über die im Auftrag der Balkankommission der k. Akad. d. Wiss in Wien durchgeführten nordostgeorgischen Dialektenstudien* (në Anzeiger, Wien, 1915). C. Tagliavini. *Le parlate albanesi di tipo ghego orientame*. K. Ulqini. *Disa vëzhgime mbi të folmen e Matit*, në Bulet. Un. Shtet. Seria Shkenc. Shoq. 3, 1961. B. Beci — *Hulumtime gjuhësore në Mat* (Fonetika), në Bulet. Un. Shtet. Seria Shkenc. Shoq. 2, 1962.

2) B. Beci — *Hulumtime gjuhësore në Mat* (Fonetika), në Bulet. Un. Shtet. Seria Shk. Shoq. 2, 1962, f. 243.

fqinjë me M. e Krujës, por siç shohim ng C. Tagliavini<sup>1)</sup> më tepër është i përhapur në zonat më lindore e verilindore të territorit ku është diftonguar i-ja.

Zanoren i të theksuar nuk e gjejmë këtu të diftonguar në çdo rast. Le të shohim se çfarë rregullsie ka në këto përjashtime.

Tek një numur i vogël rastesh që hëpërhe dalin sot me i të padiftonguar: *shiu, fis, misri, raki, hiku* (iku), *me shit*, (shpesh i gjen me diftong) duket se kemi të bëjmë me një zhvillim të ri, një ndikim nga gjuha e përbashkët.

Në rastet e tjera, që do t'i përmendim më poshtë dhe që janë në një numur pak a shumë të madh, i-ja nuk diftongohet rregullisht. Shkakun e këtij përjashtimi nuk jemi në gjendje që ta caktojmë për të gjithë shembujt.

Ka raste që tregojnë qartë se mosdiftongimi është i kushtëzuar nga pozita fonetike në të cilën ndodhet zanorja i. Kështu rregullisht i-ja e theksuar nuk diftongohet sa herë që ndodhet pranë një bashkëtingëlloreje qellzore ose pranë l-së. Në këto kushte ajo ruhet si zanore e përparme dhe e mbyllët, sepse këto bashkëtingëllore artikuloohen duke u formuar pengesa tek qiellza, ndërsa në kushte të tjera i-ja që është diftonguar, duke u zhvilluar, ka dhënë dy komponentë nga të cilët ai i pari, ai që është zhvilluar më shumë dhe që është bërë komponenti kryesor, është një zanore e hapët (shih gjendjen e sotëshme: *3<sup>l</sup>, ç<sup>l</sup>, a<sup>l</sup> . . .*): *t gjith, gj<sup>l</sup>z, kaq<sup>l</sup>, qil, me qit, fiq, liq<sup>l</sup>, ligj, m hijet, i t rijve, fij, br<sup>l</sup>ja, lidhi, dil, çilte, tu flit, katolik, skile, kaçile*, këtu duhen radhitur edhe: *gish<sup>l</sup>i* (<glishti) e *gidhi* (<glidhi = zgjidhi).

Në këtë të folme, megjithëse mund të ketë ndonjë përjashtim fare të parëndësishëm, nuk i janë nënështuar ligjit të zbërthimit fjalët e marra hua nga turqishtja: *çekrik, terin, kadai<sup>l</sup>, viqil, kambrik, bër<sup>l</sup>xhik, jeshil, benish, zana<sup>o</sup>talit, shnik, mexhida, qerpik, popçi, xhami, Liu (Aliu), Xhi (Naxhi), Dik, (Sadik), Bim (Ibrahim), Him (Ibrahim), Di<sup>l</sup>je (Sadije), Tixhe (Natixhe), Gani<sup>l</sup>ja, Velu<sup>l</sup>.*

Janë disa fjalë të shqipes që dalin konsequentisht me i dhe nuk kuptohet përse këto nuk i janë nënështuar fenomenit të diftongimit: *dit, frik, mi-shi, viç, imi, brisk, bir*.

Nuk i janë nënështuar këtij procesi edhe disa fjalët të formuara relativisht vonë, kështu p.sh. nuk gjejmë i të diftonguar tek emrat foljorë të formuar me prapashtesën *im*: *malkim, tritim, qellim, leim*, etj. Po kështu edhe disa fjalë të hyra vonë kanë i: *trisk, pulatik*, etj.

Ka një farë prirjeje që të mos diftongohet edhe i-ja, megjithëse, siç e kemi parë, ka edhe mjaft raste ku duket se ajo është diftonguar: *t<sup>l</sup>nz, brinat, mifim, ja mshini, jam ni, u shika!grihen*

Një prirje e këtyre duket edhe në shumë trajta foljore ku zanorja i është rezultat i metafonisë që ka vepruar mbi zanoret e temave të foljeve gjatë fleksionit: *kish<sup>e</sup>, ishte, me shit, vika, vijn, vdisshin, u drithte, shifshem, bini, ti b<sup>l</sup>, etj.*

y. — Karakteristike për këtë të folme, sikurse për zonat e Matit<sup>2)</sup>; Mirditës e Dibrës<sup>3)</sup>, është evolimi i zanores y, e cila këtu ka dhënë disa tinguj zanorë: 1) e labiale me dy variante: a) një e labiale të mbyllët [ϕ] dhe b) një e labiale e hapët [œ] dhe 2) y të hapët e më pak labiale se ajo e mbarë shqipes [y]. Në disa kushte të caktuara fonetike y-ja ose ka mbetur e paevoluar ose ka dhënë i.

1) C. Tagliavini — *Le parlate albane di tipo gheho orientale*.

2) B. Beci — *Hulumtime gjuhësore në Mat* (Fonetika), në Bulet. Univ. Shtet. Seria Shkenc. Shoq. 2, 1962.

3) C. Tagliavini, "Le parlate albanesi . . ."

Nga zanoret e përfuara prej zhvillimit të *y*-së më karakteristike për të folmen e Krujës është *e*-ja <sup>1)</sup> labiale në dy variantet e saj, nga të cilët në qytetin e Krujës gjejmë vetëm  $\phi$ , kurse në Malësi të dy variantet, por që më e përhapur është *æ*-ja.

Krujë: *s\phi*, *kr\phi*, *at\phi*, *gat\phi*, *h\phi p*, *kr\phi p*, *m kr\phi t*, *ulu n b\phi th!* me *p\phi t*, *m t\phi mt*, *shkr\phi th*, *sht\phi p*, *sh\phi t*, *h\phi nte*, *bësht\phi na*, *e th\phi va*, *fr\phi ma*, *mëh\phi r*, ose *m\phi h\phi r*, *përm\phi s*, *kr\phi psen* (kriporen), *l\phi pi*, *fët\phi rkuq*.

Malësi: *æll* (yll), *tæ*, *fræ*, *næ e* (nyje) *kam thkæ*, *kræp*, *pæll*, *pæet*, *nrædhe*, *mælle!*, *mihæ r*, *uçæ r* (yndyrë), *m bisht sæut*, *rræp*, *si u græse?* *soell*. Këtu, siç thamë, nuk mungojnë edhe rastet me  $\phi$ , por ky variant haset më tepër në ato fjalë ku pranë kësaj zanoreje, sidomos pas saj, ndodhet një bashkëtingëllore buzore ose *l*-ja: *kr\phi p*, *t\phi m*, *sht\phi pa*, *me t m\phi t*,  $\phi ll$ ; *p\phi ll* ose *p\phi lla*, *s\phi ll*, *m\phi ll*, por edhe: *at\phi*, *t\phi*, *kr\phi*, *sh\phi t*.

Varianti tjetër i *y*-së, një *y* më e hapët dhe më pak labiale [Y] haset herëherë në Malësi, sidomos në anën e Kurbinut (ne kemi marrë Mafsheqin dhe Noen)<sup>2)</sup>: *dY*, *hY*, *frY*, *bYtha*, *shpYrti*, *e ktYne*, *unYra*, *lYmi*.

Bashkëtingëlloret qiellzore dhe *l*-ja në këtë të folme edhe kur janë ndodhur pranë *y*-së kanë ndikuar tek ajo dhe nuk e kanë lënë të zhvillohej e të jepte zanore më të hapta siç janë *Y*-ja dhe *e*-ja me variantet e saj, prandaj në këto kushte *y*-ja në qytetin e Krujës ka mbetur fare e pandryshuar, kurse në Malësi ka kaluar në *i* më të shumtën e rasteve (i është zanore e përparme e mbyllët):

Krujë: *gjymsa*, *gjysh*, *qylymi*, *thyje!* e *lyni!* *ktlysh*; *tlyn*; Malësi: *gjysh*, *përgjimës*, *gjimi*, (gjymi), *t lini*, *ija* (yje) dhe *qipore* (qyprorë).

Edhe në qytet edhe në Malësi tek numërori *dy* dhe tek për emri *ky* zanorja *y* ka mbetur e pandryshuar.

*u*. — Ndërsa zanoret *i* dhe *y*, siç e pamë, kanë evoluar edhe në qytet edhe në Malësi, *u*-ja është zhvilluar vetëm në të folmen e qytetit, ka dhënë aty një *u* të hapët, ose më mirë të themi një *o* shumë të mbyllët [o], e cila në disa raste ndihet si një tingull jo i thjeshtë, si një diftongoid <sup>3)</sup> *o<sup>u</sup>* (në fund të artikullimit të *o*-së ndihet një tingullth *u*). Ky ndërrim nuk vërehet në të gjitha fjalët që kanë *u*.

Të dhënat e gjendjes së sotme të së folmes tregojnë se fenomeni nuk ka vepruar në një numur të madh fjalësh për shkak të pozitës ose të natyrës që ka *u*-ja në ato fjalë. Kështu nuk konstatohet sot ky fenomen pothuajse në të gjitha ato fjalë ku *u*-ja ka qenë komponent i diftongut *ue* (duket se në kohën kur diftongu *ue* u monoftongue e dha *u*, fenomeni *u > o*, *o<sup>u</sup>* kishte pushuar së vepruari): *e ka plagū*, *tu knū*, *kina për t rrū*, *jam tu kallxū*, *ā<sup>o</sup>* *tu mlu plëhur ajo*, *tu knū*, *ka liftū*, *m lujn*, *e mur vesht*, *sull*, *u mshtull*, *un me t ngjume e kam*, *i qūt*, *me grū*, etj. Raste të rralla si: *kam pas çō* (çū < çue), *i ka shkatrō* (shkatrū), *u mshtōll* (mshtull < mshtuell), *ftō* (ftū < <ftue) mund të shpjegohen vetëm me shtrirjen e fenomenit për analogji. Fenomeni nuk ka vepruar gjithashtu në fjalët ku *u*-ja është hundore dhe në ato raste ku ajo ndodhet pranë bashkëtingëlloreve qiellzore ose *l*-së (ashtu sikurse pamë për zanoret *i* dhe *y*):

1) Dy tinguj të këtillë ose të afërt me ta, të ardhur prej zhvillimit të *y*-së, ka konstatuar edhe B. Beci në krahinën e Matit (shih "Hulumtime gjuhësore", Bulet Univ. Shtet. Seria Shk. shoq. 2, 1962, f. 246).

2) Një variant pothuaj i këtillë i *y*-së haset edhe në Saxhak të Matit, katund që nuk është shumë larg prej Kurbinut (shih B. Beci *Po aty*, faqe 247).

3) Hapja e *u*-së në *o* dhe më shpesh diftongimi i saj në *ou*, *au* janë karakteristike edhe për të folmet geqe lindore (shih C. Tagliavini "Le parlate albanesi...").

a) *hûj, drût, trût, trûnqt, tûnsim, zû, kishte vû;*

b) *gjûtha, lugu, lule, ulu, uj, etj.*

Në rastet e tjera; siç thamë, në vend të *u-së* në shumë fjalë gjejmë *o* dhe në disa të pakta *o<sup>u</sup>*:

a) *rrög* (rrugë), *tōf* (tufë), *kpōct* (këpucët), *thōrr* (thurrë — forma e pjesores), *bōrr* (burrë), *fōrka* (furka), *pōshkën* (pushkën), *nōses* (nuses). *pi fōshe* (prej fushe), *t'i fōtsh* (t'i futësh), *fōtshin* (futshin), *t prō* (të prū);

b) *pō<sup>u</sup>n* (punë), *kpō<sup>u</sup>c* (këpucë), *shtō<sup>u</sup>p* (shtupë), *kō<sup>u</sup>rr* (kurrë), *prij Po<sup>u</sup>ke* (prej Puke), *katro<sup>u</sup>ve*, (katruve).

Rastet e pakta e të lëkundëshme: *burri, un, shum, sun e mushç, likūr* që dalin jashtë këtij rregulli nuk mund të kuptohen ndryshe veçse si inovacione regresive të bëra vonë nën ndikimin e gjuhës së përbashkët.

*o*. — Edhe zanorja *o* ka evoluar në këtë të folme, por më tepër në të folmen e qytetit se sa në atë të Malësisë. Sot në qytetin e Krutës gjejmë *o* (zanore e prapme të ngritjes së mesme, të radhës së mezit dhe buzore, zanore kjo që ka timbër të njëjtë me atë të mbarë shqipes), gjejmë *Λ*<sup>1)</sup> (zanore e afërt me *o*-në, por që ndryshon prej saj sepse është me e përparme dhe e delabializuar), gjejmë më në fund edhe diftongoidin *uo* (zanore *o* jo e thjeshtë, në fillim të artikulimit të së cilës ndihet një tingullth *u*). Në Malësi gjejmë vetëm *o* dhe *Λ*. Secili prej këtyre varianteve është i lidhur me gjatësinë e zanores dhe me llojin e rrokjes ku ndodhet.

Varianti *Λ* haset në ato fjalë ku zanorja *o* është e shkurtër në një rrokje të hapur ose të mbyllur, haset gjithashtu edhe në ato fjalë ku *o-ja* është e mesme në një rrokje të mbyllur të shumtën e herës nga dy bashkëtingëllore:

a) *ja, ar, ja, aja, ilsha, !shka! kas, sat, kallt; vāj, shka<sup>Λ</sup>i, kuj<sup>Λ</sup>i, ft<sup>Λ</sup>i;*

b) *shkaj<sup>Λ</sup>n, shkajshin, imt<sup>Λ</sup>jm, rrall<sup>Λ</sup>jm, nrr<sup>Λ</sup>jm, grash, n abart tëm.*

Në këto kushte e gjejmë variantin *Λ* edhe në Malësi, vetëm se këtu në një numur rastesh më të kufizuar se në qytetin e Krutës: *zat, zag, sat, kra<sup>Λ</sup>i, barxh, karp, rap, i dagj, i dabt, lshajm, qerajm, .*

Diftongoidi *uo* që është karakteristik pothuajse vetëm për të folmen e qytetit, vjen nga një *o* e gjatë dhe herëherë edhe nga një *o* e mesme e një rrokjeje të hapur brenda fjalës (zanorja në këtë pozitë është diçka më e gjatë se ajo e një rrokjeje të mbyllur):

a) *b<sup>uo</sup>ç, ç<sup>uo</sup>rb, v<sup>uo</sup>rb, (v<sup>uo</sup>rb — v<sup>ar</sup>ba), shk<sup>uo</sup>ll, e gjet tu f<sup>uo</sup>l, e f<sup>uo</sup>rt, p<sup>uo</sup> p<sup>uo</sup>;*

b) *ç<sup>uo</sup>pa, z<sup>uo</sup>ti, faqe g<sup>uo</sup>cash, shk<sup>uo</sup>opi, ll<sup>uo</sup>kma, tak<sup>uo</sup>onte, r<sup>uo</sup>obvet.*

Në më shumë raste *o-ja* e mesme që gjendet në rrokje të hapura nuk ka dhënë diftongoid, siç e pamë nuk ka kaluar as në *Δ*: *vdora, naplona, xarrona* (xarrohena = rrëzohemi), *vranthet qirosi, kofsha, thona, qofshi, kokrrat, nodhen, malcore*. Në kushte të këtilla *o-ja* ka qëndruar pa përgjithësim dhe në ato fjalë ku rrokja e hapur është rezultat i fenomeneve morfologjike që kanë ndodhur (në trajtat e foljeve të mënyrës dëftore koha e tashme veta e II dhe e III njëjës të cilat këtu me shpesh dalin pa mbaresë vetore): *pno* (pu-

1) Ky tingull është i ndryshëm për nga karakteri buzor që ka dhe për nga vendi ku artikullohet prej *o* (<*o*) të konstatuar në Dibër nga C. Tagliavini "Le parlate albanesi . . ." dhe në Mat nga B. Beci — "Fulurtime gjuhësore . . ." në Bulet. Univ. Shtet. Seria Shk. Shoq. 2, 1962, f. 248.

non), *kno* (këndon), *maro* (mbaron), *kalo* (kalon), *shlo* (lëshon), *kërko* (kërkon), *lavdro* (lavdëron), *ço* (çon) etj.

Në këtë të folme nuk ka evoluar në asnjë rast edhe  $\hat{o}$ , pavarësisht nga pozita ku ndodhet: *kllojsat*, *mickoña*, *zôn*, *niòlla*, *n'òfta*.

### Zanoret në rrokje të patheksuara

ë. — Kjo zanore e patheksuar në dialektin gegë i është nënështruar një reduktimi të madh, por, siç dihet, lloji (kualitativ) dhe shkalla (kuantitativ) e reduktimit të saj nuk janë të njëjta në të gjitha të folmet. E folmja jonë për nga shkalla e reduktimit afrohet pak në disa raste me gegërishten veriore, ndërsa për nga lloji i reduktimit mbetet e folme geqe jugore.

ë *para rrokjes së theksuar* : a) Kur është ndodhur në një rrokje nistore, pas së cilës vjen rrokja e theksuar, në disa kushte të caktuara ka qëndruar, kurse në të tjerat është reduktuar deri në zero:

1) ka qëndruar sa herë që rrokja në të cilën ndodhet është e mbyllur nga një bashkëtingëllore sonantike, sidomos nga *r* e *l*: *përshkës*, *përculle*, *përgjisëm*, *përciell*, *fërgoj*, *gërshânza*, *sun* e *lërojsh*, *bërzhik*, *tërhiqe!* *mërdhef*, *Bërret*, *pëlhur*, *Shënergji*;

2) është reduktuar deri sa është zhdukur fare në këto pozita:

a) kur është ndodhur në një rrokje nistore të hapur: *im vlla*, *vllazën*, *vre*, *lkur*, *ja lshoj*, *prij msimeve*, *goca t mdhaja*, *msoj*, *fmija*, *fla<sup>o</sup>nza*, *si gdhine?* *ta gzo<sup>o</sup>shin!* *ktu*, *kpuc*, *ksula*, *kshtu*, *klysh*, *kna<sup>o</sup>qte*;

b) kur është ndodhur në një rrokje në mes të fjalës pas së cilës vjen menjëherë rrokja e theksuar: *ushtri*, *lavdro*, *vjedh<sup>o</sup>i*, *malsi*, *bulqsis*; dhe

c) në fjalët atone proklitike: *t vogjël*, *me t dobtit*, *goca t mdhaja*, *t tashishmet*, *me t n'gjume*, *toka t kqija*, *m vjësht*, *tu m fol*, etj.

Duhet shënuar se, kur pas pjesëzës të (fjalë proklitike) vjen bashkëtingëlloja *m* (*më* — fjalë tjetër proklitike), zanorja *ë* e pjesëzës të ruhet, sepse ajo shqiptohet bashkarisht me bashkëtingëlloren pasuese *m*: *të m përciell*, *të m laj horha*; *të m b<sup>o</sup>ajsh*; edhe: *nuk ëm b<sup>o</sup> gj<sup>o</sup>*.

ë. — *pas rrokjes së theksuar*: a) nuk ndihet rregullisht në një rrokje të mezit që vjen fill pas rrokjes së theksuar: *vllaznit*, *k<sup>o</sup>mat* e *veglit*, *gjarpni*, *për ëmnit*, *m<sup>o</sup> t' dobtit*, *n'kopshitt t afrit*.

b) i njëjti fenomen ka vepruar edhe tek *ë*-jaqë ka qënë në fund të rrokjes fundore: *vdor*, *kres*, *përshkes*, *po<sup>o</sup>shk*, *ko<sup>o</sup>s<sup>o</sup>is*, *tri p<sup>o</sup>l*, *aliat*, *j<sup>o</sup>n*, *je tu m fol*, *taposht*.

c) ashtu si në tërë gegërishten jugore, edhe këtu pothuajse është ruajtur *ë*-ja e një rrokjeje fundore të mbyllur. E gjejmë të ruajtur jo vetëm në rrokje fundore që mbyllen nga bashkëtingëllore sonante, por shumë herë edhe në ato që mbyllen nga bashkëtingëllore të tjera. (E folmja e qytetit ka më shumë raste ku *ë*-ja nuk ndihet në rrokje fundore që mbyllen nga bashkëtingëllore jasonante, vetëm se kjo ndodh më shpesh kur pas vjen një fjalë tjetër që nis me zanore):

1) *vegël*, *t vogël*, *bukël*, *t<sup>o</sup>mël*, *imër*, (ymër), *hasër*, *kllosh<sup>o</sup>tër*, *hikën*, *babën*, *dulën*, *ma çil derën*, *erdhën*, *fit<sup>o</sup>rën*, *motrën*, *plëhën*, *breshën*, *vlla „zën*, *i përgjithshëm*, *qekës*, *e dorës*, *i shkollës*, *hekrat* e *zgjedhës*, *g<sup>o</sup>ja pëlhurës*, *bishti dorzës*, *m rrugët*, *pemët*, *i vokët*, *kafshët*, *t lagët*, *kularët*, *ushtarët*;

2) *hoxhallart*, *shokt*, *kpçct*, *tont*, *djerst*, *teli drugs*, *ko<sup>o</sup>s<sup>o</sup>is*, *buks*, *Durrs*, *përgjims*, *birs*, *t ja marsh*.

Në këtë të folme ashtu si për të folmet e tjera geqe është karakteristik fenomeni *ë>i* në pozicion protonik dhe pranë një bashkëtingëllojeje qell

zore ose likuideo *l*: *nigjai*, *qinroni*, *qirajm*, *tok qi z v3<sup>1</sup>*, *ka tre vjet qi sjam*, *i kaqi*, *n'i plum*, *likur*, *ka liftu*.

u. — Nga zanoret e tjera të patheksuara *u*-ja është ajo që ka pësuar një reduktim të madh: ka kaluar një herë në *ë* dhe kjo pastaj ka marrë po atë rrugë sikurse *ë*-ja që përmendëm më sipër. Kalimi *u > ë* vërehet vetëm kur *u* ndodhet para një bashkëtingëlloreje sonantike, sidomos para *l*, *r*, *ll*.

Reduktimi i *u*-së vetëm deri në *ë* vërehet në rrokje fundore e nistore të mbyllura nga bashkëtingëllore sonante:

a) *flutër*, *lepër*, *hekër*, *kungëll*, *vjetëll*, *vetëll*, *sjetëll*, *mjegëll*, *ufëll* ose *uthëll*, *shpatëll*;

b) *bërtëk* (purtekë), *gërmâzin*, *cëndhesh* (cundhesh=banor Cadhini). Fort rrallë ruhet kjo *ë* (<*u*) në kushte të ndryshme nga ato që përmendëm më sipër: *bëcel*, *kërr3<sup>1</sup>*, *mëstage*, *këllostin*.

Në pozitat e tjera ajo (*ë*<*u*) është reduktuar deri në zero:

a) në rrokje nistore të hapët: *mlon*, *mlês*, *klLOT*, *kllojM*, *mlar*, *zblū*, *pno*, *ta pnojsh*, *klloŋsa*, *klloštër*, *zllumin*, *t zhlume*, *kmonës* (edhe: *fqi*, *ksur*, *ksa<sup>1</sup>*=kusi);

b) në rrokje protonikesemiatone dhe postonikesemiatone:

1. — *hekri*, *vetlla*, *poplli*, *pusllet*, *shpatlla*, *avlli*.

2. — *me i rregllū*, *ta regllojsh*, *qesh sigrū*.

o. — Zanorja *o* e patheksuar këtu shpesh herë jep *a* në një rrokje nistore pas së cilës vjen menjëherë rrokje e theksuar: *naksa<sup>o</sup>n*, *katec*, *mator*, *gamâ<sup>o</sup>r*, *shkadra<sup>n</sup>*, *gavat*, *kanâ<sup>o</sup>qet*, *kaditi* (goditi=ndreq), *apeŋës*, *damâ<sup>o</sup>te*, *Kavaçe* (kovaçe — toponim në Krujë), *Badrumet* (Bodrumet — toponim në Krujë).

Po në një pozitë të këtillë në një numër rastesh shumë të kufizuara, si domos në fjalë neolatine, kjo zanore ka dhënë *u*: *pulicija*, *kumunja*, *kumâ<sup>o</sup>ndantit*, *pulatika*, *kumita*, *uris*, *tuger*.

### Diftongje dhe togjezanores

ue. — E folmja e Krujës bën pjesë në atë trevë dialektore të Shqipërisë Veriore ku diftongu *ue* ka marrë rrugën e monoftongimit dhe ku ky proces ka përfunduar sot plotësisht. Dhe me të vërtetë në Krujë e në Malësi so në të gjitha rastet dhe në të gjitha pozitat ku ka pasur diftong *ue* gjejmë vetëm *u*.

a) *falku*, *vargu*, *gru*, *i delegu*, *thu*, *mu*, *blu* (bluan vet. III nj.), *je tu shkrū*, *t dū*, *me e copū*, *ka liftū*, *i ka zgjū*, *e ka plagū*;

b) *frur*, *qur*, *qershur*, *mëzatur*, *shull*, *shkus*, *i qut*, *sull*, *e mur*, *dul*, *lirum*, *sa t dush*;

c) *dulëm*, *mshtullën*, *përculla*, *prij asaj gruje*, *un me t n'gjume e kam: lujta*.

ye. — Edhe ky diftong ka ndjekur në këtë të folme po atë rrugë sikurse *ue*, dmth. edhe procesi i monoftongimit *ye > y* ka përfunduar plotësisht. Zhvillimi fonetik që ka pësuar *y*-ja (shih paragrafin ku flitet për zanoren *y*) ka prekur dhe *y*-në që ka qenë komponent kryesor i diftongut *ye* dhe që ka mbetur pas monoftongimit të tij:

a) *me pΦt*, *krΦt*, *n krΦ*, *krΦkuqe*, (më tepër në Krujë);

b) *ja kishte kthæ*, *kan kthæ* (kthye), *me ka thæ*, *t pæS* (më tepër në Malësi).

c) *t lÿn*, *e lÿn*, *lyje!* *dÿr*, *shÿtën*, dhe : *jam tu n'i* (ngjye).

ie. — Shumica e të dhënave tregojnë se zhvillimi i diftongut *ie* si në qytet edhe në Malësi ka qenë fonetiki i kushtëzuar prej pozitës ku ndodhej në fjalë.

Pothuajse kudo në rastet ku diftongu *ie* ka qenë në fund të fjalës në rrokje të hapur është monoftonguar duke mbetur elementi rrokjeformues *i*, kjo pastaj herëherë ka ndjekur rrugën e zhvillimit të zanores *i*: *tì b<sub>i</sub><sup>1</sup>*, *s u b<sub>i</sub><sup>1</sup>*, *me e z<sub>i</sub><sup>1</sup>*, *me përzi*, *zìjm*, e *përzime* dhe *ke n<sub>i</sub><sup>1</sup>* (ke ndie), a *n<sub>i</sub><sup>1</sup>ve?* (ndieve?)

Në pozitat e tjera në shumë raste diftongu ka mbetur i pandryshuar (ka mbetur diftong ngjithës):

— *dill*, *m<sub>i</sub><sup>1</sup>ll* (mill < miell), e *dìel*, *bieri!* *mos ma biesh!* (qytet).

— *diell*, *dielli*, e *diela*, *q<sub>i</sub><sup>1</sup>ell* por edhe *qilla*, *i përziën*, *m<sub>i</sub><sup>1</sup>ll* dhe *m<sub>e</sub><sup>1</sup>ll* (Malësi).

Numurorin *dhjetë* herë e gjejmë *dhit* ose *dheit* (< dhit), herë e gjejmë *dhët* (kjo e fundit vetëm në Malësi).

Diftongun *ie* e gjejmë rregullisht të paevoluar në temat e atyre foljeve që e bëjnë aoristin me apofoni dhe që e kanë këtë diftong në disa nga trajtat e tyre: *miellin*, *të m përciell*, *viel*, *mshtuell*, *me viell*, *me riëp*.

### Bashkëtingëlloret

*h*. — I. — Me përjashtim të pak rasteve ku ndodhet në mes të fjalës, bashkëtingëllorja *h*, si në qytet edhe në Malësi, shqiptohet e pareduktuar:

a) në fillim të fjalës: *ha*, *ho<sup>1</sup>tat*, *haroj*, *heret*, *hasër*, në *hijet*, *hidhnohet*, *hamar*, *ho<sup>1</sup>xa*, *hallve*;

b) në mes të fjalës: *mëh<sup>1</sup>r*, *duhani*, *sahat*, *rehatll<sup>1</sup>ku*, *i rahatshëm*, *kohja*, *për krahi*, *malherët*, *pluhun*, *tërhiqe!* *priher*, *shtathöll*, *plehën*, *duhet*.

Në mes të fjalës, kur *h*-ja është element antihiatizues, shumë herë ndihet si tingull i rrëgjuar, por herëherë edhe nuk ndihet fare *ruhen*, *rehen*, *thahet*, *bâhena*, *për krahësh*, *pl<sup>1</sup>ehnen*, *gjuhën* dhe: *t përziët*, *marroem*.

Në pak fjalë *h* del edhe si element anorganik protetik: *hecte*, *tu hent pëllhur*.

II. Fenomenin *h > f*, që është karakteristik për të folmet gege, e gjejmë edhe këtu. Dihet se ky fenomen nuk ka vepruar në të njëjtën masë në të gjitha të folmet veriore,<sup>1)</sup> në Shqipëri të Mesme ai është shtrirë në më shumë raste, kurse në Veri në më pak raste. E folmja e Krujës në këtë drejtim më shumë afrohet me të folmet e Shqipërisë së Mesme: *t rraf*, *s jam tu mër-dh<sup>1</sup>f*, *jam tu mif*, *mçef*, *shof*, *n<sup>1</sup>iof*, *u mçef*, *rrafa*, *ta ftofs<sup>1</sup>h*, *me e n<sup>1</sup>ioft*, *ta nefsh*, *mçes!<sup>1</sup>* e *rrafim*, *t grofen*, *ja*, *i her t nifna*; *pi s ftohtit*, *â<sup>1</sup> ftofët*, edhe: *dufëm* (duh).

*nj*.

Ashtu si në të folme të tjera gege, edhe këtu kjo bashkëtingëllore qiellzore hundore ka evoluar, dhe në pozita të ndryshme të caktuara ka dhënë tinguj të ndryshëm.

Bashkëtingëllorja *nj* që është në fund të fjalës dhe që paraprihet nga një zanore çfarëdo, duke u artikulluar si një tingull shumë sonant, ka përfunduar në *j*, e cila shumë herë ndihet si një tingëll gjysmëzanor<sup>2)</sup>:

1) E. Çabej — Për historinë e konsonantizmit të shqipes, në Buletini i Univ. Shtet. Seria Shk. Shoq.; 1. 1958, f. 63.

- a) tek foljet: *qaj*, *t bá<sup>o</sup>j*, *zá<sup>o</sup>j*, *vênoj* (vendos), *shkarkoj*, *shkoj*, *ti lshoj*;  
 b) tek mbaresa e shumësit të emrave mashkullorë: *pêi*, *hûi*, *kûi*, *qeriit*,  
*venalii*, *shkopij*, *ftai*, *thoit*;  
 c) tek emrat femërore të pashquar: *rrâ<sup>o</sup>i*, *brii*, *fii*, *zoi*, *mickôi*.

Kur është ndodhur ndërmjet dy zanoreve ose kur është paraprirë nga një zanore dhe është pasuar nga një bashkëtingëllore, në të shumtën e rasteve nuk është spirantizuar plotësisht, ka dhënë një tingull i cili i ruan akoma, megjithëse në një masë të vogël, karakterin pëlçitës dhe nuancën hundore, është një tingull ndërmjet pëlçitës *nj* dhe frikatives *j* ([*n̥*]<sup>1</sup>): *dΦná* ose *dñája*, *Viñá<sup>o</sup>ll*, *klloñsat* (kullonjaat), *qínq* (qengj) edhe *mickôna*, etj.

Kur është ndodhur në fillim të fjalës ose edhe në mes pas një bashkëtingëlloreje, ka dhënë *n* dentale të palatalizuar [*n'*], në vend të së cilës në shumë raste shqiptohen dy tinguj: *ní me e n'oft*, *ta n'efsh*, *n'ofti*, *n'at maje* (ngjat . .), *n'er ke t nezi*; *n'erk*, *n'ierzit*, *i niôm*, *niálllet*, *n'ati*, *i bruznâ<sup>o</sup>n*.

Bashkëtingëllorja *nj* e fillimit të fjalës -, kur është pasuar nga zanorja *i* e theksuar, ka dhënë një herë *nî* dhe më në fund, pasi është shkrire *i* me *i*-në e theksuar të temës, ka përfunduar në *n*: *nifem*, *ja i her t nifna*, *jam tu e ni* (jam tue e ngjye).

Fjala *një* (numuror, përemër, nyje, mbiemër përcaktor) dhe fjalë të tjera, ku ajo bën pjesë si rrënjë ose si komponent i fjalës, herë janë të theksuara dhe herë të patheksuara, kështu që bashkëtingëllorja *nj* në këto raste ndodhet në kushte të ndryshme fonetike. Duke qenë në kushte të ndryshme fonetike, ajo (*nj*-ja), në këto fjalë ka dhënë tinguj të ndryshëm; por gjithmonë sipas rregullsisë që përmendëm më parë:

Tek fjalët e theksuara, kur është në fillim të tyre ose edhe në mes; por pas bashkëtingëlloreve, ka dhënë *n'* ose *nî* dhe *n* (kjo e fundit kur pas *nj* vjen *i* e theksuar): *n'â<sup>o</sup>ni* ose *niâ<sup>o</sup>ni*, *niâ<sup>o</sup>*, *ni*, *asni*, *her ni her ni*, etj. ; po në këto fjalë, kur është ndodhur ndërmjet dy zanoreve, nga të cilat zanorja pasuese është e theksuar, ka dhënë *i*: *noi* (ndónji > no<sup>i</sup> > noi);

në fjalët, ku theksi nuk bie tek komponenti *një* bashkëtingëllorja *nj* e ndodhur ndërmjet dy zanoreve, ka dhënë *i*: *noi* (ndónji > nô<sup>i</sup> > noi);

në rastet, ku fjala *një* ka qenë atone dhe ka pasur në frazë përpara vehtes një fjalë që mbaronte me zanore, *nj*-ja ka dhënë *i* (ashtu si *-nj*- e ndodhur ndërmjet dy zanoreve) dhe kjo pastaj është shkrire me zanoren *i* pasuese: *më i bisht gama<sup>o</sup>ri* (me një bisht > me <sup>i</sup> bisht > me <sup>i</sup> bisht > më <sup>i</sup> bisht). Nga këto raste zhvillimi i *nj* > *i* është përgjithësuar edhe në raste të atilla ku *nji* ndodhet në fillim të frazës ose kur fjala që vjen para saj mbaron me bashkëtingëllore: *i rrâ<sup>o</sup>i* (nji rrâ<sup>o</sup>nj > ii rrâ<sup>o</sup>i > i rrâ<sup>o</sup>i), *i thot i plake* (nji plake > ii plake > i plake), *prî hër*, etj. <sup>^</sup> <sup>^</sup>

f e th

Meqënëse nuk kemi një material të mjaftueshëm, po kufizohemi duke dhënë vetëm disa shembuj ku duket ndërrimi i njërës bashkëtingëllore me tjetrën: me *laf3 i t* (lajthit=gaboj), *ufllat* ose *ofëll* (uthull), *thëll* (Kr. — fellë) dhe *thagëll* (Cu. = fëngjill).

1) Një tingull të tillë të përfutur nga *nj*, ka vërejtur edhe R. Nachtingali në disa të folme të Shqipërisë së Mesme, shih "Die Frage der einheitlichen albanischen Schriftsprache".

## q e gj

Këto bashkëtingëllore, qofshin primare; qofshin të ardhura nga grupet *kl* e *gl*, nuk kanë këtu ndonjë variant dialektor me interes si në të folmet më veriore geqe, por do të japim disa shembuj ku *q* e *gj* të paraprira respektivisht nga një *s* ose *sh* dhe *z* kanë kaluar në *j* (mund të merren edhe si raste të një asimilimi të pjesëshëm): *sjap* (squp), *sjoll*, (*sqoll*) *sjetëll* (sqetull), *shjep* (shqep), *zjedha* (zgjedhja).

## l

Po japim pak shembuj për *l* e pasuar nga një bashkëtingëllore pëlçitëse, e cila në shumë të folme ka kaluar në *j*, kurse këtu ose ka mbetur ose është zhdukur dhe nuk ndihet sot: *kallt* (kuajt), *bulq*, *bulqsis*, *falkū* dhe *uku* (ujku).

## Grupe bashkëtingëlloresh

*mb, nd*

Në të folmen për të cilën po bëjmë fjalë grupet *mb* e *nd* janë asimiluar dhe kanë dhënë respektivisht *m* (<mb) e *n* (<nd), të cilat pothuajse janë bashkëtingëllore sonante, pra ashtu si edhe në të folmet e tjera jugore të gegërishtes. Në qytetin e Krujës na është bërë shumë herë sikur *m* (<mb) e *n* (<nd) janë disi të zhurmëshme, ashtu si në të folmet me veriore geqe<sup>1</sup>.

1. grupi *mb*: *mushje*, *mrapa*, *myte*, *mlesa*, *mrën* (brenda), *mreti*, *u ka marū*, *përm* *Φs*, *pamuk*, *parmrā<sup>o</sup>mit*, *n maj t' shka<sup>o</sup>mit*, *zamak*, *thumi ustës*, *plum*;

2) grupi *nd*: *nr Φshe*, *nigj<sup>o</sup>aj*, *të nodhen*, *nô<sup>o</sup>*, *nrroj<sup>o</sup>m*, *n3<sup>i</sup>*, *katuni*, *funi*, *muni*, *tu menu*, *kani<sup>l</sup>*, *përkune!* *mënja*, *shpëni*, *masanaj*, *grina*, *krā<sup>o</sup>n*, *vën*, *parmën*.

*ng*

Në qytetin e Krujës ky grup bashkëtingëlloresh është asimiluar dhe ka dhënë një bashkëtingëllore grykore hundore e cila këtu nuk është aqë sonante sa në të folmet e tjera të gegërishtes jugore: *ηela*, *ηrehem*, *u ηrit*, *me hā<sup>o</sup>ηēr*, *baba i Duηut*, *kuηuj*, *lā<sup>o</sup>ηza*, *lā<sup>o</sup>ηzīm*, *tiηll3<sup>o</sup>m*, *kā<sup>o</sup>η*.

Dy katundet e Malësisë, Cudhini e Mafsheqi, jo vetëm që ndryshojnë me Krujën në këtë drejtim, por ndryshojnë edhe ndërmjet tyre.

Cudhini, që bën pjesë në Benë, dallohet për rrugën e veçantë të zhvillimit të këtij grupi. Aty, siç duket, nëpërmjet të reduktimit të elementit të parë, *n*, grupi ka përfunduar në *g<sup>2</sup>*, ka mbetur elementi i dytë: *me gā qiet*, *grej*, *ka gel*, *du me e grēt*, *t grosem*, *garkoj*, *si u grāse? pegës*, *kam hā<sup>o</sup>gēr*, *cugal-i*. Ka edhe raste ku grupi *ng*, në mes dhe në fund të fjalës, ka mbetur i pandryshuar: *kungëll*, *kungi* (trajta e shumësit e fjalës *kungull*), *apengës*, *kā<sup>o</sup>ng*, *lā<sup>o</sup>nk* (lang).

1) W. Cimochowski ka konstatuar në Dushman *m* (<mb) e *n* (<nd) të zhurmëshme — shih "Le dialecte de Dushmani", Poznan, 1951.

2) Një zhvillim të këtillë ka bërë grupi *ng* edhe në një pjesë të krahinës së Matit — shih B. Beci, "Hulumtime gjuhësore . . ." Bulet. Univ. Shtet. Seria Shk. Shoq. 2, 1962, f. 258. I njëjti fenomen haset edhe në disa zona të skajit v.l. të Shqipërisë — shih J. Gjinari, "Vërejtje mbi të folmen e Gashit, Krasniqes e Butycit të rrethit të Tropojës", në Bul. Univ. Sht. Seria Shk. Shoq., 4, 1963.

Meqënëse rastet e  $ng > g$  janë më të shumta kur elementi i parë i grupit mund të jetë një parashtesë, mund të mendohet edhe se  $n$  (parashtesë) të mos ketë ekzistuar, mirpo këtë sikur e kundërshtojnë rastet ku  $ng > g$  ka ndodhur në mes të fjalës në një morfemë.

Në katundin Mafsheq, që bën pjesë në Kurbin, shihet se është më e përgjithëshme ruajtja e grupit  $ng$ , asimilimi në  $\eta$  haset më rrallë: *ngref*, *ungrefte*, *me ngā*, *kishin ngel*, *opž'ngën* dhe: *kam ηel*, *ηul*, *mos i ηa!* *Buza e Ca°ηut*.

### ngj

Mund të thuhet se ky grup, si në qytet edhe në Malësi, është asimiluar dhe ka dhënë *nj*, e cila pastaj si e tillë ka marrë rrugën e zhvillimit (shih bashkët. *nj*): *niala* (ngjala), *nīallet* (ngjallet), *t i gas nīer me di or dit* (gjer); *nīati pak enē...* (ngjati); *s kam qēn nīat me kēt dreq* (ngjatë); *qiñq* (qenj)<sup>2</sup>; *jam tu ni* (ngjye); *e nymja* (e ngjyemja).

### fsh

Ashtu si në shumë të folme të Shqipërisë së Mesme edhe këtu gjejmë *msh* në vend të grupit *fsh*. Duhet thënë se *msh* gjendet vetëm në fillim të fjalës në ato raste ku elementi i parë i grupit është një parashtesë!): *mshais* (fshesë), *mshaim* (fshijmë), *mçef* (fshëh) *mshžikëll* (fshikull), *mshull* (mbështolli — krh.: fshtolli), *mshet* (mbëstet — krh. fshtet), kurse: *kofsha*, *qofshi*, *të zgofshin!* etj.

## Fenomene fonetike

### Shurdhimi

Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme që ndodhen në fund të fjalës është kryesisht një fenomen karakteristik për Jugun, por haset dhe në Shqipëri të Mesme. Në të folmen e Krujës krahas: *larg*, *u derdh*, *zaggjt*, etj. gjejmë shumë herë: *shurth*, *ka lith*, *i math*, *u gith*, *garth*, *burk*, *lā°nk*, *djek*, *rop*, *korp*, *xhup*, *murg*, *qiñq*, *mā°s* — *ma°zi*.

### Asimilimi

Ky nuk është ndonjë fenomen karakterizues për këtë të folme, por, megjithatë, po japim disa shembuj ku në disa raste shihet asimilimi i plotë dhe në disa të tjera asimilimi i pjesëshëm:

a) *viqil* (veqil), *Vilikā°ni*, (Velikani), *marak* (merak).

b) *krygja* (kryqza), *zhduku* (çduku) *vahud* (fxhud < fuxhud), *kavazllaje* (kafasllie), *zhdo gjā°* (çdo...), *zdū* (z due), *z bā°* (s bân), *huthte*, *u lothsh truñqt*, *enc* (<ents < ends < ëndës).

1) Aleksandër Xhuvani — Eqrem Çabej "Parashtesat e gjuhës shqipe" në Bulet. i Univ. Shtet. Seria Shoq. 4, 1954, f. 71.

### Metateza

Edhe këtu, ashtu si në shumë të folme të Shqipërisë së Mesme për të cilat është karakteristik fenomeni i metatezës, ndërrojnë vendin tingujt e një rrokjeje ose të rrokjeve të ndryshme: *shloi bleta, e shlumja, pküc, tue pkut, kena pshu* edhe *bështoi, u vdesha, vdora, u fillonte, e mshtjellmja plëhurës; nevrā; u xarru, nakafa* (nafaka), *nagaçe, zarjaki, zdërvek; pylka* (pykla), *preglla* (pjergulla).

### Fenomeni i rënies

Tingujt në rrokje të patheksuara, sidomos në ato që ndodhen para rrokjeve të theksuara, duke u ndodhur në një pozicion të dobët, kanë prirje të reduktohen fare, të mos shqiptohen. Ky fenomen nuk është i përgjithësuar në të gjitha këto lloje rrokjesh, por, megjithatë, gjejmë një numur të mirë rastesh ku konstatohet prirja e reduktimit:

1. Rënie në një rrokje nistore para së theksuarës:

a) *nkim* (ankim), kush je t<sup>3</sup>, re? (ore), *tu gjëru* (tue ligjëru); b) *pnojshin* (punojshin), *mrela* (murjela), *zllumin* (zullumin) *væhud* (vuzhud), *shplaka* (shumplaka), *s mite* (simite), *ftyra* (fytyra), *dña'ja* (dynjaja).

2. *gocvet* (gocavet), *naplona* (napolona);

Nuk po përmendim këtu rënien e tingujve dhe rrokjeve që duken rregullisht tek emrat e shkurtuar të personave, fenomen ky që është mjaft i përhapur këtu: *Liu* (Aliu), *Xhi* (Haxhi), *Time* (Fatime), *Dik* (Sadik), etj.

3. rënia në fund të fjalës (apokopa) vërehet vetëm tek trajtat foljore të mënyrës dëftore koha e tashme veta e dytë dhe e tretë njëjës: *kalo* (kalon), *pno* (punon), *shlo* (lëshon), *maro* (mbaron) *lavdro* (lavdëron), *blu* (bluen), *frϕ* (fryn), *nuk hy* (hyn), *ba* (ban) *po vjen* (vjen), etj.. Meqënëse kjo vërehet ve vetëm në këto raste të caktuara, mund të jetë një fenomen morfologjik.

### Elidimi

Të bie në sy në radhë të parë elidimi i një zanoreje, zakonisht i ë-së dhe e-së, tek fjalët atone proklitike, kur pasohen nga fjalë që fillojnë me zanore: *t enme për tramâ'j, q aqi qekësh, q i dha, q u vrã, m i vrã*.

Dihet se në disa të folme të shqipes elidohet njera nga nyjet në një togfjalësh të përbërë prej një emri të shquar dhe një mbiemri të nyjshëm ose një emri në gjindore. Në të folmen e qytetit të Krujës, ashtu si në shumë të folme të Shqipërisë së Mesme, elidohet më të shumtën e herës nyja e përparme e mbiemrit dhe dëftorthe i gjindores: *goja pëlhurës, pulatika tij, e mshtjellmja plëhurën*; herëherë këtu shihet edhe e kundërta: elidohet nyja e prapme e emrit të shquar: *ke shp<sup>3</sup>i e vet, pun e ullive, dit e breshnit, qim e mësteqes*.

Në Malësi zakonisht ndihen të dyja nyjet në një togfjalësh të tillë: *udha e mar! shplaka e dorës, shputa e këmës, fmija e burrit*.

Nuk folëm për rastet kur si pjesë e parë e togfjalëshit është një emër maskullor i shquar, sepse zakonisht shihet që në të gjitha të folmet e shqipes elidohet nyja e përparme e mbiemrit dhe dëftorthe i gjindores: *shuli pãr, shkopi shulit, prefti shkërët, plaku katunit*, etj.

